



VENDIM

Nr. 41 Datë 02.05.2012

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “F”, 5 pika 1 gërma “F” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licënsave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.05.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HYDRO SALILLARI” sh.p.k”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licënsimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licënsimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “HYDRO SALILLARI” sh.p.k” plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licënsave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “HYDRO SALILLARI” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.